



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program **E Drejta Civile (2023-2024)**

Fakulteti	Drejtësia
Cikli i studimeve	Cikli i tretë (doktoratë)
SETK	180
Kodi	N-PhDLAWCV180C
Titulli	Doktor i Shkencave Juridike / Drejtimi: E Drejta Civile
Numri në arkiv i akreditimit [180]	03-3479/1
Numri në arkiv i akreditimit []	
Vendimi për fillim me punë	
Data akreditimit	28.09.2023

Përshkrimi i programit

Programi studimor *e drejta civile* synon të ofrojë një gamë të moduleve që do të përbëjnë bazën e informacioneve dhe të dijeve të avancuara mbi lëndët juridike civile me qëllim të aftësimin profesional të studentëve për profesionet themelore juridike që lidhen me këtë lëmë duke ofruar njohuri solide, të veçanta dhe sistematike mbi institutet dhe konceptet e të drejtës civile në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe njohuri krahasuese nga rajoni dhe BE-ja.

Karriera

Diploma e programit studimor do t'u mundësojë studentëve të studimeve të doktoratës të aftësohen për punën hulumtuese shkencore në lëmin e shkencave juridike civile si dhe për mësimdhënie në universitetet në vend dhe jashtë vendit, me ç'rast aktivisht do të jenë të kyçur edhe në procesin e fuqizimit të resurseve të veprimtarive të pushtetit shtetëror në drejtim të procesit të integriteteve euroatlantike të vendit.

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

- Ka dituri të hollësishme nga e drejta civile, si ajo materiale ashtu edhe nga ajo procedurale, njëherësh edhe nga normat themelore në lëmenjtë kryesorë të së drejtës civile;
- Ka njohuri të hollësishme të parimeve dhe instituteve të së drejtës civile, përfshirë edhe origjinën dhe përmbajtjen e tyre;
- Vlerëson lëmin e së drejtës civile në mënyrë kritike, nga këndvështrimi shkencor dhe praktik;

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

- I zhvillon dhe i avancoon shkathtësitë e hulumtimit analitik dhe të zgjidhjes së problemeve në teori dhe praktikë nëpërmjet përdorimit të akteve legjislative dhe praktikës gjyqësore;

- Identifikon dhe analizon probleme më të komplikuar, duke marrë pjesë aktive në të gjitha fazat e procedurës civile dhe mund të interpretojë çështje të ndërlikuara të legjislacionit civil;

Aftësitë për të vlerësuar

- I zhvillon dhe i avancoon shkathtësitë e hulumtimit analitik dhe të zgjidhjes së problemeve në teori dhe praktikë nëpërmjet përdorimit të akteve legjislative dhe praktikës gjyqësore;
- Identifikon dhe analizon probleme më të komplikuar, duke marrë pjesë aktive në të gjitha fazat e procedurës civile dhe mund të interpretojë çështje të ndërlikuara të legjislacionit civil;

Aftësitë e komunikimit

- Përdor terminologji adekuate për çështje komplekse dhe specifike në sferën e shkencave juridike-civile;
- Sjell vendime më të avancuara dhe punon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe efektive në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore civile;
- Angazhohet aktivisht në argumentimin dhe debatin shkencor;
- I përdor gjuhët zyrtare të universitetit dhe ka shkathtësi të avancuara të teknologjive të informimit në punën shkencore;

Aftësitë e të mësuarit

- Zhvillon rregullorë të punës kërkimore që përdoret në profesionin e tij;
- Zhvillon një praktikë të mësimit të vazhdueshëm duke u angazhuar në trajnimin e personave që punojnë në institucionet shtetërore për parandalimin e kriminalitetit;

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [DLAW0101] [10.0 SETK] **Metodologjia e hulumtimit**
- [C2370] [10.0 SETK] **E drejta civile (programi i zbatuar)**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [DCV01033] [10.0 SETK] **E drejta procedurale civile (programi i zbatuar)**
- [E2782] [10.0 SETK] **E drejta afariste (program i zbatuar)**
- [10.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 3

- [DCV0104] [10.0 SETK] **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**
- [C2378] [30.0 SETK] **Punë kërkimore-shkencore**

Semestri 4

- [PHD-S3-S4-02] [15.0 SETK] **Publikime I**
- [C2020] [5.0 SETK] **Mobiliteti i studentëve**

Semestri 5

- [DCV0105] [20.0 SETK] **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**
- [PHD-S5-01] [10.0 SETK] **Publikime II**

Semestri 6

- [CV-PhD-THESIS] [30.0 SETK] **Disertacioni i doktoratës**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Metodologjia e hulumtimit**

Kjo lëndë është dizajnuar për studentët që përgatiten për punimin e projekt tezës së doktoratës. Qëllimet kryesore të lëndës janë që studentëve t'u ofrohen vegla për konceptualizimin e tezës së tyre në raport me gjetjen e pyetjes hulumtuese dhe krijimin e metodave për mbledhjen e të dhënave për analizë cilësore. Lënda fokusohet në problemet e metodave sasiore dhe të teknikave, siç është analiza statistikore, tekstet që lidhen me teorinë dhe testimin e hipotezave. Me rëndësi janë edhe temat për inferencë deskriptive dhe kauzale, hulumtime longitudinale krahasuese dhe studime të rastit. Informacione të avancuara do të ofrohen për mbledhjen e të dhënave duke punuar në tekst. Qëllimi është analiza e të dhënave sasiore, vendosja finale e të gjitha veprimeve teorike dhe praktike në dizajnimin dhe shkrimin e tezës.

- **E drejta civile (programi i zbatuar)**

Qëllimi i lëndës: •T'i pajisë studentët me njohuri të avansuara nga e drejta civile duke u mundësuar të tregojnë •pse në situata të caktuara jetësore zbatohen institutet përkatëse të së drejtës civile. •T'i aftësojë studentët të interpretojnë në mënyrë adekuate normat që rregullojnë materien e •së drejtës civile; •Të gjejnë normat juridike të cilat janë relevante për zgjidhjen e një rasti juridiko-civil; •Të zhvillojë shkathtësi kritike të analizimit dhe interpretimit të normave të ndryshme të të •drejtës civile nga sistemet me të rëndësishme juridike nëpërmjet metodologjisë krahasuese. •Të nxisë mendimin analitik dhe kritik të studentët lidhur me problemet me të cilët •ballafaqohet sot e drejta civile në RMV-së.

- **E drejta procedurale civile (programi i zbatuar)**

Qëllim i lëndës: -të aftësojë studentët që në mënyrë të pavarur të identifikojnë dhe analizojnë në mënyrë kritike institucionet bazë të së drejtës procedurale civile -të zhvillojë aftësi për zbatimin e njohurive të marra në praktikë në lidhje me zhvillimin e proceseve gjyqësore civile.

- **E drejta afariste (program i zbatuar)**

Qëllimi i lëndës: Të aftësojë studentët të njihen me rregullat ligjore për kryerjen e një veprimtarie. Mënyra e organizimit të subjekteve afariste, kushtet për themelimin dhe regjistrimin e subjekteve afariste dhe pronarit të vetëm, si dhe mënyrat e përfundimit të subjekteve afariste; mënyrat e krijimit të një marrëdhënie juridike biznesi, kushtet për shfaqjen e atyre marrëdhënieve, efektet dhe pasojat; që kanë të bëjnë me letrat me vlerë: hake për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe mënyra për të mbrojtur subjektet e biznesit nga konkurrenca e padrejtë: mënyra për të mbrojtur konsumatorët, etj.

- **Shqyrtimi dhe miratimi i planit të disertacionit të doktoratës**

Pas semestrit të dytë, studenti fillon aktivitetet e tij për përpilimin e planit mbi disertacionin e doktoratës. Aktivitetet përfshijnë përcaktimin e literaturës, përcaktimin e kornizës hipotetike, përkufizimin e metodologjisë së punës dhe përcaktimin e planit individual si dhe prezantimin e parë publik.

- **Punë kërkimore-shkencore**

Në vitin e dytë (semestri 3 dhe 4) kandidati vazhdon me veprimtarinë kërkimore shkencore sipas planit individual të miratuar. Mentori siguron vlerësimin lidhur me këto aktivitete në formën e një raporti drejtuar Këshillit mësimesh-kërkimesh të fakultetit.

- **Publikime I**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Mobiliteti i studentëve**

Qëllimi i mobilitetit të doktorantëve është të prezantojnë, shkëmbejnë dhe diskutojnë punën e tyre kërkimore me kolegë nga vendet e tjera evropiane për të përmirësuar cilësinë e disertacionit të tyre.

- **Prezantimi i rezultateve të hulumtimit**

Në fund të semestrit të 5-të, pas aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas planit individual, kandidati do t'i prezantojë

publikisht rezultatet e përgjithshme të kësaj faze të punimit dhe të hulumtimit.

- **Publikime II**

Publikimi i aktiviteteve kërkimore-hulumtuese sipas tabelës me rëndësi për mediat për publikim. Aktivitetet dhe sukseset publicistike të kandidatit kontrollohen para audiencës shkencore sipas lëmit dhe relevancës së hulumtimit.

- **Disertacioni i doktoratës**

Vazhdimi i punës së disertacionit të doktoratës. Dorëzohet teza (disertacioni), pranohet nga Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit, u dorëzohet anëtarëve të komisionit dhe fillon procedura e mbrojtjes publike.

Lëndë zgjedhore

- **E drejta civile e krahasuar**

Qëllimi i lëndës: •T'i pajisë studentët me njohuri themelore nga aspektet më të rëndësishme të së drejtës së krahasuar; •T'u paraqesë studentëve metodologjinë krahasuese në studimin e së drejtës civile; •Të ju ofrojë studentëve njohje më të mirë të së drejtës nacionale përmes studimit të të drejtave të huaja; •Të zhvillojë shkathtësi kritike të analizimit dhe interpretimit të normave të ndryshme të të drejtës civile nga sistemet me të rëndësishme juridike nëpërmjet metodologjisë krahasuese.

- **E drejta familjare evropiane**

Në këtë lëndë plotëson studentët e studimeve të doktoraturës do të fokusohen në institucionet më të rëndësishme dhe më të reja të së drejtës familjare: familjen bashkëkohore; çështjet martesore - pushimi i martesës, përgjegjësia prindërore, kujdestaria e fëmijës pas shkurorëzimit (përgjegjësia e përbashkët prindërore pas shkurorëzimit), ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve; kontrata martesore; çështjet lidhur me mbrojtjen së fëmijës - abuzimi dhe neglizhimi i fëmijëve dhe sistemi i mirëqenies së fëmijëve; si dhe mund të orientohen në studimin e njëjës nga fushat subspecialiste - E drejta ndërkombëtare e familjare; Reformat në legjislacionin familjar të RMV-së; Të drejtat ndërkombëtare të fëmijëve - pro future; Përfaqësimi i familjeve të të njëjtës gjini; Krijimi i familjes përmes teknologjive të reja të reproduktimit artificial. Studentët gjithashtu do të mësojnë për perspektivat lidhur me unifikimin dhe harmonizimin e të drejtës familjare në Evropë si dhe rolin dhe kontributin e Komisionit për të drejtën familjare evropiane në këtë drejtim. Përmes kësaj lënde studentët, do të mësojnë për kompetencën e Unionit Evropian në çështjet familjare. Ata, gjithashtu, do të analizojnë dhe interpretojnë vendimet gjyësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në drejtim të mbrojtjes së nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

- **E drejta e pronësive intelektuale**

Qëllimi i lëndës e Drejta e Pronësisë Intelektuale është t'i aftësojë studentët për: -të kuptuar sistemin kompleks të të drejtave të pronësisë intelektuale, si dhe rregullimin ligjor të tyre -të kuptuar llojet e ndryshme të të drejtave të pronësisë intelektuale dhe mënyrën e krijimit, realizimit dhe mbrojtjes së tyre -të qenë në gjendje të vënë në qarkullim në mënyrën e duhur të drejtat e pronësisë intelektuale -t'u përgatitur për dhënien e provimeve profesionale për përfaqësues në këtë fushë -të fituar aftësinë për të zbatuar me efikasitet kornizën ligjore në këtë fushë, si një fushë e re dhe me perspektivë e së drejtës.

- **E drejta trashëgimore e krahasuar**

Qëllimi i lëndës: Në këtë lëndë studentët e studimeve të doktoraturës do të fokusohen në karakteristikat kryesore të sistemeve juridike-trashëgimore në Evropë dhe shtetet tjera si në sistemin kontinental poashtu edhe në sistemin anglosankson. Përmes kësaj lëndë studentët do të analizojnë edhe vendimet e Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut në sferën e trashëgimisë. Vëmendje të veçantë do të ju kushtohet kontratave trashëgimore si dhe harmonizimit të së drejtës trashëgimore.